

VENDIM
Nr. 267, datë 10.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 606, DATË 14.9.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR PËR AKTIVITETET JASHTË ORARIT MËSIMOR DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 54, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 606, datë 14.9.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Titulli zëvendësohet me “Për zbatimin e programit “pas shkolle””;

b) Kudo në vendim, fjalët “... Programi/et Kombëtar/e për Aktivitetet jashtë Orarit Mësimor (JOM) ...” zëvendësohen me “... programi/et “pas shkolle” ...”;

c) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Zbatimin e programit “pas shkolle”, i cili është i organizuar dhe i strukturuar në veprimtari, që zhvillohen jashtë orarit mësimor të detyruar dhe ka për qëllim përf forcimin e të nxënësve dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të aftësive edukative, sociale, sportive, kulturore dhe krijuese të nxënësve, i miratuar sipas ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

ç) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Programi “pas shkolle” realizohet në institucionet arsimore parauniversitare publike të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë.”.

d) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Pagesa për një orë mësimore për zbatimin e programit “pas shkolle” për mësuesit dhe trajnerët, për veprimtaritë që zhvillohen jashtë orarit mësimor të detyruar, është 1 000 (një mijë) lekë.”.

dh) Pikat 4, 6 e 6/1 shfuqizohen;

e) Aneksi 1, bashkëlidhur vendimit, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama